

Partia e Gjelbër u krijuar për t' u përballur me sfidat që janë në Shqipëri.

Partia e Gjelbër ka një vizion për shoqërinë tonë të ardhme.

Vizioni ynë bazohet në:

mbrojtjen e ambjentit, paqen, ekozhvillimin, barazinë dhe drejtësinë sociale.

Ne e shikojmë të ardhmen në mënyrë optimiste dhe besojmë se së bashku luftojmë për një shoqëri demokratike, afatgjate dhe të qëndrueshme, ku njerëzit të marrin

përgjëgjësi, si në aspektin lokal, ashtu edhe në aspektin kombëtar.

Ne dëshirojmë që vendimarrja të jetë në dorë të sa më shumë njerëzve.

Ne dëshirojmë të jetojmë në një ambjent sa më të pastër, me ajër, ujë dhe ushqime të shëndetshme që të na sigurojnë një jetë sa më të mirë.


Ne respektojmë vlerat e kulturës sonë kombëtare dhe besojmë në vlerat e traditës sonë shekullore, në vlerat e jetës, lirisë, paqes, drejtësisë, tolerancës dhe solidaritetit.

Ne dëshirojmë që të jetojmë në një vend modern ku bazë e modelit tonë shoqëror të jetë: demokracia dhe ekozhvillimi.

Ne sot na duhet një politikë ndryshe, ku mjedisi të jetë prioritet i politikës.

Në qendër të politikës sonë ambjentaliste është implementimi i një politike të re që synon ndalimin e ndotjes së mjedisit dhe pakësimit të CO2 në ajër.

Nuk mund të ketë një zhvillim të qëndrueshëm në një sistem që nuk përdor energjitë e rinovueshme, transportin ekologjik dhe nuk ka si prioritet ruajtjen e burimeve natyrore, shtimin e hapësirave të gjelbëra, stimulimin e produkteve të sigurta, ruajtjen e shëndetit si dhe politikat sociale të sigurisë.



Në qendër të politikës sonë të re është ruajtja e biodiversitetit humëlojshmërisë së gjallesave, krijimi i kushteve për një bujqësi organike larg OMGJ-ve, krijimi i një strategjie për burimet ujore dhe ruajtjen e cilësisë së ujit të pijshëm.

Kjo politikë e re do të na çojë drejt një sistemi i cili do të na garantoj përfitimin e të mirave materiale dhe një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen.

Ne besojmë që nuk ka demokraci pa drejtësi. Politikat e gjelbëra i kanë rrënjët në principet e drejtësisë, të cilat kërkojnë një shpërndarje më të mirë të të mirave materiale.

Ne jemi për një politikë moderne si një shans i ri jete, dhe një përgjegjësi afatgjatë për mjedisin. Ne dëshirojmë t' u ofrojmë njerëzve mundësi të jetojnë në një Shqipëri ku mbretëron barazia në mes gjinive.

Për Partinë e Gjelbër është plotësisht e qartë se të gjithë njerëzit kanë vlerë të njëjtë dhe të drejta themelore të barasvlerëshme.

Çdo njeri ka të drejtë të aspirojë për mirëqënien dhe lumturinë e vet, të ndërtojë të ardhmen e vet dhe të familjes së tij, në këtë vend europian me një progres të vazhdueshëm.

Ne aspirojmë për një Shqipëri me shumë dashuri dhe respekt për të parët tanë, pasi frytet që gëzojmë ne sot janë: sakrifica dhe djersa e atyre që kanë punuar gjithë jetën për të jetuar në paqe dhe me dinjitet.

Ne mendojmë që, Shqipëria që ne aspirojmë, të jetë një realitet. Ne na duhet të ndryshojmë mentalitetin si në qeverisje, ashtu dhe në administrimin e saj.

Ne duhet të zëvendësojmë praktikën e vjetra burokratike me një frymë të re bashkëkohore.

Shqipëria ka nevojë për njerëz që dinë të veprojnë, për njerëz të përgatitur dhe që e kanë të qartë se ç' duhet të bëjnë, ka nevojë për njerëz që dinë të transformojnë programet në rezultate konkrete.

Ata duhet të jenë njerëzitë e shpresës, besimit, optimizmit për brezat e rinj.

Shqipëria ka nevojë për një rrugë të re zhvillimi.

Për këtë arsye në Të Gjelbërit kemi ndërtuar një program shprese të thjeshtë, të qartë dhe me vlera që t'i kthejë vendit besimin tek e ardhmja, sidomos tek ajo Europiane.

Partia e Gjelbër është përgjigjja më e mirë që mund të japim në mbrojtje të vlerave tona të përbashkëta duke filluar nga mjedisi.

Të frymëzuar nga këto vlera fisnike, ne dëshirojmë të japim kontributin tonë për të ndërtuar një të ardhme më të mirë në këtë vend ku rreh zemra jonë.

Një Shqipëri e Gjelbër. Ky është thelbi i Manifestit tonë politik, i cili përmban ide të reja politike ku prioritet kanë zhvillimin e qëndrueshëm dhe ruajtjen e ambjentit.

Une besoj se ky manifest paraqet shkurt dhe qartë atë rrugë të re zhvillimi të një progresi të gjithanshëm për të cilën ne kemi nevojë.

Ne dëshirojmë të ndërtojmë një Shqipëri të Gjelbër.

Nëse dhe ju doni, bashkohuni me ne, mbështeteni Partinë e Gjelbër, përkrahni atë, votoheni atë që këto ide të zhvillohen dhe të bëhen realitet për të mos ngelur thjesht në letër.